

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Biznesi në vështirësi nga rënia e euros dhe rritja e kostove, prodhuesit në Shkodër: Na krijoni lehtësira që të ekzistojmë - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/biznesi-ne-veshtiresi-nga-renia-e-euros-dhe-rritja-e-kostove-prodhuesit-ne-shkoder-na-krijoni-lehtesira-qe-te-ekzistojme
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:36:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:34:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	63ac6a2be5604a6f3e9652a278b7a3a0048b09a2371404cf99ebc1bef3fc487f
TEKSTI	ec9e48b5a7fefdfdb88c3ef0fa01def945287131f40c62abae3e5ed329b974bb
PAMJA	7c065106bea6dd08cd3fe36226c193cca9851f8a73730c5f3e3727c6bce6325b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f7a75cffc143b1e09946232a4f78bd962c3d405a484cd87d03ce6f649b300d0b
E MËPARSHMJA	3ca0cdcc6a07f5eacaa1481f076bc60ff0e3541e1be5c95f5b96c783613f966e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f7a75cffc143b1e09946232a4f78bd962c3d405a484cd87d03ce6f649b300d0b

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



E shtunë me reshje shiu, parashikimi i motit për sot (VIDEO)

<>

Ekonomi

Biznesi në vështirësi nga rënia e euros dhe rritja e kostove, prodhuesit në Shkodër: Na krijoni lehtësira që të ekzistojmë

Sipërmarrësit e fasonerive në Shkodër kërkojnë politika lehtësuese përballë vështirësive që po hasin pas rënies së euros dhe rritjes së kostove të prodhimit. Shqetësimet u ngritën gjatë takimit të prodhuesve shkodranë me shoqatën e Manufakturës Shqiptare.



Ergys Kavaja

25 Shtator, 17:31 | Përditësimi: 25 Shtator, 17:56

Share Tweet

A A

Rënia e vlerës së euros si dhe rritja e kostove të prodhimit janë ndër shqetësimet kryesore me të cilat po përballen bizneset prodhuese në të gjithë vendin.

Prodhuesit për eksport në qarkun e Shkodrës dëshmojnë se po punojnë në kufijtë e mbijetesës. Një pjesë e fabrikave e kanë ndërprerë aktivitetin, ndërsa të tjera kompani tashmë po e shikojnë si rrezik ekzistencën duke vënë në pikëpyetje dhe punësimin e qindra grave dhe vajzave që janë të punësuar në këtë sektor.

Shqetësimet, prodhuesit shkondranë i ndanë gjatë një takimi me shoqatën e Manufakturës Shqiptare.

[Sh]
.com



LEXO EDHE:
Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, taksia përplasat me furgonin me mësues! 3 të plagosur

"Për herë të parë pas 36 viteve, sektori i manufakturës së këpucëve del në vend të dytë. Ka qenë eksportuesi më i madh në Shqipëri, në disa vite të veçanta ka rritje të eksporteve. Hera e parë në muajin gusht që ne dalim në vend të dytë dhe mineralet e karburantet në të parin, një dramë e madhe për sektorin. Po të marrim shifrat, në 2022 ne numëronim 65 mijë të punësuar, ndërsa tani numri është reduktuar në 25 mijë", tha kryetari i shoqatës, Florian Zekja.

Bizneset gjatë këtij takimi kërkuar kushte që do t'u mundësonin të kalonin drejt ciklit të plotë të prodhimit, nga sigurimi i lëndës së parë dhe aksesoreve deri te produkti përfundimtar "Made in Albania". Në kuadër të lehtësive për të kaluar krizën më të cilën ata përballen u kërkuar dhe rishikimi i tarifave doganore për materialet që vijnë nga vende jashtë Bashkimit Europian.

"Të gjithë të ardhurat tona janë në valutë dhe shpenzimet në lekë. Zhvlehtësimi i euros bën të ardhura shumë më të vogla në lekë", thotë biznesmeni [Edi Teli](#).

"Biznesi lëviz në vendet ku krahu i punës është më i lirë. Në momentin që bëhet afër atij të BE, shpërngulet. Ne kemi shpërngulur një pjesë të mirë të prodhimit të Uzbekistan", thotë [Gjergj Leqeja](#).

Shoqata e prodhuesve synon që shqetësimet e ngritura prej tyre të adresohen gjatë hartimit të politikave fiskale dhe ekonomike, me qëllim ekzistencën e kompanive prodhuese të cilat rrezikojnë të zhvendosen drejt vendeve ku krahu i punës është më i lirë.

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Shkodër euro prodhim vendas edi teli Gjergj Leqeja

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★

★ ★ ★ ★ ★ 1.0 / 5 (1 vlerësim)



Komente

Komento



Ndalohej repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**

22 Shtator, 16:08

Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

Po

Jo

Disi

Lajme të tjera



Reforma territoriale, Këshilli Bashkiak i Shkodrës jep pëlqimin! PD voton kundër, debate edhe për statusin e Dukagjinit dhe Velipojës (VIDEO)



Ergys Kavaja

25 Shtator, 13:04



Hemodializa sërish privatit, anulohet tenderi 50 milionë euro! Agjencia e Prokurimit Publik: Gabime dhe mangësi në dokumente

25 Shtator, 12:54



Avokatët njoftuan se GJKKO urdhëroi SPAK për nisjen e hetimeve për resortin e Ulajit në Rrjoll, Prek Molla: Lajm i mirë! Paralajmëroj shqiptarët që të mos blejnë në 'Baks Bay', s'do i gëzojë askush pronat tona

24 Shtator, 19:40



Tym i dendur mbulon aksin Lezhë-Shkodër, zjarret në të dy anët e rrugës rrezikojnë qarkullimin (VIDEO)

24 Shtator, 16:46



Art dhe humor, 'Shkodra ka plot dashuri' vjen në teatrin 'Migjeni' për pesë netë radhazi



Ergys Kavaja

24 Shtator, 15:25



Dyshohet se kultivoi 143 bimë kanabisi në Vilës të Vaut të Dejës, arrestohet 50-vjeçari (VIDEO)

24 Shtator, 11:15



Resorti luksoz i Bashkim Ulajt në Rrjoll, avokatët: GJKKO urdhëroi SPAK të nisë hetimet! Banorët pretendojnë se tokat iu vodhën me dokumente false

23 Shtator, 16:22



Me pamje të re dhe kushte bashkëkohore, shkollat e rindërtuara të Shkodrës mirëpresin nxënësit

23 Shtator, 08:54



Dronë, radarë dhe makina inteligjente në akset e Shkodrës, mbi 2200 gjoba në dy javë! 2 shoferë në pranga, 9 leje drejtimi të pezulluara

20 Shtator, 14:31



Vllaznia prek fundin pas humbjes 0-2 me Teutën! Xhaferri kërkon dorëheqjen e Martinit, tifozët sulmojnë



Koplik/ E kishin kthyer lokalit në 'fole' droge dhe bastesh, arrestohet punonjësi, në kërkim administratori (VIDEO)



Eduard Zalosnjaja: A u rrit turizmi këtë sezon në Shkodër dhe Pogradec?



Eduard Zalosnjaja

autobusin e durrakëve
(VIDEO)
18 Shtator, 23:01

18 Shtator, 09:00

16 Shtator, 19:56

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.